



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1186/9 prot.

Datë 26.07.2022

V E N D I M

Nr. 715/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.07.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “2AT” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-28369-05-11-2022, me objekt: “Blerje Klori”, me fond limit 2,857,680 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 23-05-2022 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës-Kanalizime Kamëz Sh.A.

Ankimues: “Albania Distribution Chemicals” SHPK
Rruga e Kavajës, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Ujësjetllës Kanalizime Kamëz Sh.A
Rr. “Paqësori”, Frutikulturë, Kamëz,

Subjekti i Interesuar: Operatori ekonomik “2AT” SHPK
Dishnicë, Korçë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë

13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11.05.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit *E hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-28369-05-11-2022, me objekt: “Blerje Klori”, me fond limit 2,857,680 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 23-05-2022 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës-Kanalizime Kamëz Sh.A.

II.2. Në datën 23.05.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 26.05.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

- “2 AT” SHPK	2 222 640	lekë	kualifikuar
- “Albania Distribution Chemicals” SHPK	2 593 080	lekë	kualifikuar
- “Atlantik 3” SHPK	pa ofertë		skualifikuar

II.5. Në datën 27.05.2022 autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim Fituesit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

II.6. Në datën 2022-06-02 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1186/2022 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2254 e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “2AT” Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “2AT” SHPK të kriterit si më poshtë vijon:

- Shtojca 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik”

2.3.3 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik certifikatën e analizës nga Instituti i Shendetit Publik ose nga laboratore të certifikuar, për analizë toksikologjike për produktin që prokurohet (certificate analize brenda 3 muajve të fundit).*

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1186/2 prot datë 06.06.2022.

II.8. Me shkresën nr. 1252/4 prot, datë 03.06.2022 protokolluar me tonën me nr.1186/3 datë 06.06.2022, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur refuzimi i ankesës.

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik i interesuar “2AT” SHPK, ka dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore.

II.10. Me shkresën nr. 1186/6 prot datë 24.06.2022 me lëndë “Kërkesë për informacion” drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, Komisioni i Prokurimit Publik kërkoi informacion nëse Tenuis Laboratories SHPK është i certifikuar për kryerjen e analizës toksikologjike për produktin Hipoklorit Natriumi.

II.11. Me shkresën nr. 259/1 prot datë 06.07.2022 Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit në përgjigje të shkresës së sipërcituar ka sqaruar si vijon: *Ju informojmë se Tenuis Laboratories ShPK është i akredituar për matricat e analizave të ndryshme toksikologjike që lidhen me*

Hipoklorit Natriumin, por nuk është i certifikuar për kryerjen e analizës toksikologjike për produktin e mirëfilltë Hipoklorit Natriumi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik 2AT SHPK me argumentet, se ky i fundit nuk plotëson kriterin “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik certifikatën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik ose nga laboratorë të certifikuar, për analizë toksikologjike për produktin që prokurohet (certifikatë analize brenda 3 muajve të fundit)*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik certifikatën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik ose nga laboratorë të certifikuar, për analizë toksikologjike për produktin që prokurohet (certifikatë analize brenda 3 muajve të fundit).*

III.1.2. Në shtojcën 6 “Formulari i Sasisë Dhe Grafikut të Lëvrimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Sasia e mallit që kërkohet:

52920 kg i (lëngshëm)

Afatet e lëvrimit:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Bletje klori 13%-15% (i lëngshëm)	52920	UKK-sha	12 muaj / 4410 kg në muaj

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezultojnë, se operatori ekonomik “2AT” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Raport-Analizë nr.386 datë 29.04.2022 lëshuar nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë me përmbajtje si vijon: Për mostrën Hipoklorit Natriumi të paraqitur nga subjekti analiza fiziko kimike rezultojnë brenda parametrave normal.
- Raport-Analizë datë 27.04.2022 lëshuar nga Tenuis Laboratories lidhur me mostrën Hipoklorit Natriumi.

III.1.4. Me shkresën nr. 1186/6 prot datë 24.06.2022 me lëndë “Kërkesë për informacion” drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, Komisioni i Prokurimit Publik kërkoi informacion nëse Tenuis Laboratories SHPK është i certifikuar për kryerjen e analizës toksikologjike për produktin Hipoklorit Natriumi.

II.1.5. Me shkresën nr. 259/1 prot datë 06.07.2022 Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në përgjigje të shkresës së sipërcituar ka sqaruar si vijon: *Ju informojmë se Tenuis Laboratories ShPK është i akredituar për matricat e analizave të ndryshme toksikologjike që lidhen me Hipoklorit Natriumin, por nuk është i certifikuar për kryerjen e analizës toksikologjike për produktin e mirëfilltë Hipoklorit Natriumi.*

III.1.6. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.7. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“ 3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.*

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin

dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht se *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik certifikatën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik ose nga laboratorë të certifikuar, për analizë toksikologjike për produktin që prokurohet (certifikatë analize brenda 3 muajve të fundit).”* Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “2AT” SHPK për përmbushjen e kriterit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ky i fundit ka paraqitur Raport-Analizë nr.386 datë 29.04.2022 lëshuar nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë me përmbajtje si vijon: Për mostrën Hipoklorit Natriumi të paraqitur nga subjekti analiza fiziko-kimike rezulton brenda parametrave normale. Raport si dhe Raport Analizë datë 27.04.2022 lëshuar nga Tenuis Laboratories lidhur me mostrën Hipoklorit Natriumi. Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumenteve të tenderit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “2AT” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua me shkresë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, duke kërkuar informacion nëse Tenuis Laboratories SHPK është i certifikuar për kryerjen e analizës toksikologjike për produktin Hipoklorit Natriumi. Referuar kthim-përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, KPP konstaton se laboratorit Tenuis Laboratories SHPK është i akredituar për matricat e analizave të ndryshme toksikologjike që lidhen me Hipoklorit Natriumin, por nuk është i certifikuar për kryerjen e analizës toksikologjike për produktin e mirëfilltë Hipoklorit Natriumi. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “2AT” SHPK me dokumentacionin e paraqitur, nuk e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, “kriteret e veçanta të kualifikimit”, “kapaciteti teknik” pika 2.3.3, pasi në përmbushje të kriterit më sipër ka ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik një certifikatë analizë toksikologjike për Hipokloritin e Natriumit nga një laborator i paakredituar për të kryer analiza për produktin e mirëfilltë Hipoklorit Natirumi, referuar kjo përgjigjes së institucionit kompetent Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit. Pra, sa më sipër, për sa kohë autoriteti kontraktor ka kërkuar në dokumentet e tenderit, që operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë certifikatën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik ose nga laboratorë të

certifikuar, për analizë toksikologjike për produktin që prokurohet, dokumenti certifikatë analizë toksikologjike e paraqitur nga operatori ekonomik “2 AT” SHPK në këtë procedurë prokurimi, nuk është i vlefshëm, pasi Tenuis Laboratories SHPK, i cili e ka lëshuar këtë certifikatë analizë nuk është i akredituar për analizën toksikologjike për produktin e mirëfilltë Hipoklorit Natriumi ashtu siç është kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Ndërsa Raport-Analiza nr.386 datë 29.04.2022 lëshuar nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë me përmbajtje si vijon: Për mostrën Hipoklorit Natriumi të paraqitur nga subjekti analiza fiziko-kimike rezulton brenda parametrave normale, është një analizë fiziko-kimike dhe jo toksikologjike sikundër kërkohet në kriterin e veçantë të kualifikimit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përputhen në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Në këtë kuadër Komisioni gjykon, se operatori ekonomik “2AT” SHPK me dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik, nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 115 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-28369-05-11-2022, me objekt: “Blerje Klori”, me fond limit 2,857,680 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 23-05-2022 nga autoriteti kontraktor, Ujesjelles-Kanalizime Kamëz Sh.A.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “2AT” SHPK, si dhe të korrigojë shkeljet, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri